



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.143, Datë 06.09.2017

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE BLUE STAR” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “The Blue Star” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 5(pesë) – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI